



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 92/7 Prot

Tiranë, më 28.01.2022

V E N D I M

Nr. 3, datë 28.01.2022

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, SIPAS KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 (konfirmime shtesë, faza e parë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale në pamundësi financiare për të mbuluar tarifën vjetore të shkollimit”, i ndryshuar me VKM Nr. 779, datë 26.12.2018, VKM Nr. 40, datë 23.01.2019, VKM Nr. 251, datë 27.03.2020, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 269, datë 29.03.2017” si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 92/6 Prot., datë 27.01.2022, në mbledhjen e tij të datës 28.01.2022,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve, sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2021-2022 (konfirmime shtesë, faza e parë) (sipas tabelës bashkëlidhur).
 2. Efektet financiare të këtij vendimi (për 153 studentë që plotësojnë kriteret) janë në vlerën 4,517,000 (*katër milion e pesëqindë e shtatëmbëdhjetë mijë*) lekë.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta	DOLLANI	Kryetar
Sokol	DURO	Anëtar
Fran	GJINI	Anëtar
Donika	KËRÇINI	Anëtar
Pjeter	GURALUMI	Anëtar
Marin	MEMA	Anëtar
Albert	KOPALI	Anëtar



Konceptoi: N. Ndoci